

SHKOLLAT E MESME TË PËRGJITHËSHME

PROFILI NATYROR

PJESA I

DRITËRO AGOLLI – “*Ora e gurit*”

Ky gur është ora që shekujt tregon tek e tek
Mbi fushën e tij me rrudha prej dheu,
Dikur shënoi: “katërmëdhjetë shekuj e pesë vjet”,
Kur lindi këtu Skënderbeu.

Në dorë një orë sekondat, minutat dhe orët tregon,
Ky gur i bekuar rrëfen mes rrudhave shekujt.
Tik-takun e tij, e dëgjon?
Shënon i reptë shekujt që zbresin nga mjegujt.

Ky gur është orë që askush s’ë kurdis e s’ë ngreh,
Vitet e shekujt rrëfen në çaste vyshkje e blerimi;
Vetëm kur lind një tjetër i madh Skënderbe
Tik-taku i tij pushon një çikë në shenjë nderimi.

Për pyetjet 1-5 rretho vetëm shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

1. Ç’lloj poezie është kjo?

1 pikë

- A) E natyrës.
- B) Intime.
- C) Meditative.
- D) Atdhetare.

2. Cilat janë dy fjalët kyç të kësaj poezie?

1 pikë

- A) Guri dhe (at)dheu.
- B) Guri dhe Skënderbeu.
- C) Guri dhe shekujt.
- D) Guri dhe mjegujt.

Matura Shtetërore 2007, Teste

3. Domethënia e epiteteve *i bekuar* dhe *i rreptë* për gurin lidhet me: **1 pikë**
A) krenarinë për historinë e këtij vendi.
B) ndikimet e filozofisë bektashiane te Agolli.
C) një koncept pagan për origjinën hyjnore të këtij vendi.
D) mostjetërsimin e racës shqiptare në këtë tokë.
4. Nisur nga konteksti i kësaj poezie *guri* shënon konceptin metaforik të: **1 pikë**
A) universit.
B) kohës.
C) kufirit.
D) themelit.
5. Cili është nënteksti i vargut të parë të strofës së tretë? **1 pikë**
A) Të vërtetat e historisë nuk i ndryshon dot individi.
B) Ndryshimi i kohës është vetëm në dorë të krijuesit të saj.
C) Toka, ashtu si guri, nuk tjetërsohet.
D) Një jetë njerëzore mund të rrrokë kuptimin universal të kohës.
6. Shpjego metaforën e *gurit* përballet *rrudhave prej dheu*. Ç' shënon secila prej tyre në këtë poezi? Argumento mendimin tënd. **4 pikë**
7. Cila është e veçanta që sjell poeti në portretizimin e figurës së Skënderbeut? Pse e ka dhënë me fjalë datën e lindjes së Heroit Kombëtar? **4 pikë**
8. Interpreto kuptimin e vargut: *Vitet e shekujt rrëfen në çaste vyshkje e blerimi*.
Çastet e kujt janë këto? Mbi cilën figurë stilistike e mbështet interpretimin tënd? **3 pikë**
9. Shiko me kujdes emrin *mjegujt*. Shumësi i kësaj fjale është një thyerje e normës standarde të gjuhës shqipe. Shkruaj shumësin e rregullt dhe shpjego arsyen stilistike të kësaj forme të zgjedhur nga autorri. **2 pikë**
Shumësi: _____
Shpjegimi: _____

Letërsi dhe gjuhë shqipe, sesioni I

10. Gjej në poezi një çift antonimesh. **1 pikë**
11. Cili është sinonimi i fjalës *i rreptë* (nisur nga konteksti i poezisë)?
i rreptë _____ **1 pikë**
12. Argumento në formë eseje njërin nga variantet e mëposhtme:
A ose B **10 pikë**
- A. Lexo me vëmendje dy vargjet e fundit të poezisë, ku theksohet ideja e papërsëritshmërisë së dukurisë me emrin Skënderbe. Motivo mendimin se pesha emocionale e kësaj poezie kulmohet në to.
- B. Individ mund ta ndalë kohën, qoftë edhe për një çast.

PJESA II

VIKTOR HYGO - “Katedralja e Parisit” (*fragment*)

Të nesërmen në mëngjes, kur u zgjua, ajo e kuptoi që kishte fjetur dhe kjo gjë e çuditi. Esmeralda kishte kohë që nuk flinte. Një rreze gazmore e diellit, që po lindte, hyri nga dritarja dhe i ra asaj në fytyrë. Njëherësh me diillin, në dritare u duk edhe diçka tjetër, që i kalli frikën: fytyra e fatziut Kuazimodo. Padashur ajo i mylli sytë përsëri. Por më kot. I dukej sikur edhe përmes qepallave të saj ngjyrë trëndafili po e shihte atë maskë përbindëshi, i cili ishte qorr me një sy dhe i kishte dhëmbët si çataj. Atëherë, ndërsa po i mbante sytë myllur, ajo dëgjoi një zë të vrazhdë, që po fliste plotëmëlsi:

- Mos u trembni, mua më keni mik. Erdha të shihja nëse po flinit. Unë nuk ju bëj ndonjë të keqe në qoftë se vij të shoh nëse flini, apo jo? Ç’punë ju prishet nëse unë rri këtu, kur ju i mbani sytë të myllur. Tani po iki. Shikoni, tani jam prapa murit. Ju mund t’i hapni sytë.

Dhe, më i përvajshëm se fjalët, ishte theksimi me të cilin ai i shqiptonte ato. Cigania, e ngashëryer, hapi sytë. Te dritarja nuk kishte asnjieri. Ajo u afrua atje dhe pa gungaçin e shkretë, që ishte struktur në një qoshe të murit, kryeulët dhe i brengosur. Atëherë vajza e mposhti me pahir neverinë që i ngjallte dhe i tha me ngadalë:

- Ejani.

Nga lëvizja e buzëve të saj, Kuazimoda pandehu se ajo po e dëbonë; atëherë ai u ngrit dhe, duke ecur çalë-çalë, u largua kokëvarur, pa guxuar as t’i hidhte Esmeraldës vështrimin e tij, që ishte i mbushur me dëshpërim.

- Ejani, pra!- thirri ajo.

Por ai vazhdoi të largohej. Atëherë vajza doli nga qelia, e arriti atë dhe e zuri për krahu. Kur ndjeu dorën e saj, Kuazimodos i shkuat mornica në trup. Ai i hodhi asaj një vështrim përgjérues me syrin e tij të vetëm dhe, duke parë se ajo po kërkonte ta afronte, i rrëzelleu fytyra nga gjëzimi dhe përmallimi. Ajo deshi ta fuste në qelinë e saj, por ai u tregua kokëfortë dhe qëndroi te pragu.

Letërsi dhe gjuhë shqipe, sesioni I

- Jo, jo, - ia bëri ai, - bufi nuk mund të hyjë në folenë e laureshës.

Atëherë ajo u ul hijshëm mbi shrat bashkë me dhinë, të cilën e zuri gjumi te këmbët e saj. Që të dy ndenjën një copë herë pa lëvizur dhe në heshtje: ai duke soditur bukurinë e saj dhe ajo duke u habitur me shëmtimin e tij. Vajza po zbulonte te Kuazimoda për çdo çast një shëmtim të ri. Vështrimi i saj hidhej prej atyre gjunjëve të shtrembër te shpina gungaçe, prej shpinës gungaçe te syri i vetëm. Ajo nuk arrinte ta kuptonte se si mund të kishte në botë një kriesë kaq të shëmtuar. Por këtë shëmtim e mbulonte një melankoli dhe një butësi aq e madhe, saqë pak nga pak ajo filloi të mësohej me të.

Gungaçi e theu heshtjen i pari:

- Më thatë të kthehesha?
- Po, - iu përgjigj ajo, duke pohuar me kokë.
Ai e kuptoi atë pohim me kokë.
- Medet!- vazhdoi të thoshte ai si me ngurrim. –Unë jam...shurdh.
- I shkreti!- thirri vajza me një shprehje plot dashamirësi dhe dhimbsuri.
Ai buzëqeshi me hidhërim.
- Si ju duket: vetëm kjo më mungonte, apo jo? Kurse ju jeni kaq e bukur!
Në zërin e atij fatziu ndihej një brengë aq e thellë, saqë ciganes nuk i bëri zemra të thoshte asnjë fjalë: le që Kuazimoda as që do ta kishte dëgjuar. Ai vazhdoi:
- Kurrë s'e kisha ndjerë shëmtimin tim kaq fort sa tanë. Kur e krahasoj veten me ju, më vjen keq për veten time, për një përbindësh të mjerë siç jam unë. Pa më thoni: unë ju dukem si ndonjë egërsirë pylli, apo jo? Ju jeni një rreze dielli, një cirkë vese, një këngë bilbili. Kurse unë jam diçka e llahtarshme, as njeri dhe as kafshë; jam një send më i vrazhdë, më i shëmtuar dhe më i përcmuar se një copë gur!

Ai zuri të qeshte dhe asgjë në botë nuk mund të krahasohej me atë të qeshur, që të copëtonte zemrën.

Matura Shtetërore 2007, Teste

Për pyetjet 13-17 rretho vetëm shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

13. Hygo është shkrimtar: **1 pikë**

- A) ekzistencialist.
- B) realist.
- C) romantik.
- D) simbolist.

14. “Katedralja e Parisit” është roman: **1 pikë**

- A) epope.
- B) historik.
- C) klasik.
- D) sentimental.

15. Shkaktar i fundit tragjik të Esmeraldës bëhet: **1 pikë**

- A) arroganca e Febyosit.
- B) pasioni demoniak i Frolos.
- C) pasioni njerëzor i Kuazimodos.
- D) pasioni i shfrenuar i turmës.

16. E veçanta e stilit të autorit në paraqitjen e atmosferës në këtë fragment shfaqet në: **1 pikë**

- A) dialogun.
- B) hollësitë artistike.
- C) kontrastin artistik.
- D) përshkrimet.

17. Indin e këtij romani e përbëjnë situatat: **1 pikë**

- A) absurde.
- B) të jashtëzakonshme.
- C) tipike.
- D) tragjike.

Letërsi dhe gjuhë shqipe, sesioni I

- 18.** Në ç'vetë është ndërtuar rrëfimi? Ç'raptot krijon autori me personazhet përmes një rrëfimi të tillë? **2 pikë**
- 19.** Qëndrimi i Esmeraldës kundrejt Kuazimodos ndryshon gradualisht. Gjej fazat nëpër të cilat kalon ky ndryshim bashkë me foljet kyç që e shprehin atë. **4 pikë**
- 20.** Zbulo, përgjatë fragmentit, një çift antonimesh që shpreh kontrastin që ekziston midis dy personazheve. **1 pikë**
- 21.** Komento, përmes figurave të stilistikës, gjendjen shpirtërore të Kuazimodos, në fjalët e tij që përbyllin këtë fragment? Ç'mund ta ketë shkaktuar atë? **5 pikë**
- 22.** Gjej aforizmin e përdorur në këtë fragment dhe interpretoje atë duke iu referuar të paktën dy prej parimeve të romantizmit. **3 pikë**